

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME POSTDIPLOMIKE

DEPARTAMENTI: KUSHTETUES-ADMINISTRATIV



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

“Historia kushtetuese e Kosovës”

Mentori:

Prof. Dr. Arsim Bajrami

Kandidatja:

Arianita Hetemi

Prishtinë, 2023

ABSTRAKT

Republika e Kosovës, ka filluar një realitet të ri kushtetues, që kishte rezultuar pas miratimit të deklaratës së pavarësisë në Kuvendin e Kosovës me 17 shkurt 2008. Ky realitet i ri kushtetues ishte derivat i një mbikëqyrje ndërkombëtare të Kosovës për tetë (8) vite me radhë nga misioni i veçantë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), që ishte një model krejt i veçantë i administrimit të një shteti nga ana e mekanizmave ndërkombëtar, në prizmin e praktikave krahasimore.

Për të realizuar këtë studim, kemi aplikuar tri fazat si në vijim:

Faza e parë: zgjedhja e literaturës: - Qëllimi i përzgjedhjes së literaturës ishte përcaktimi i mirë i fushës së studimit, gjenerimi i pyetjeve kërkimore, evidentimi i asaj çka është arritur dhe çka mbetet për t'u arritur nëpërmjet thellimit të njohjes. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër të konsiderueshëm autorësh të ndryshëm. Në këtë punim u përfitua mjaft nga burimet e informacionit të përdorur.

Faza e dytë: mbledhja e të dhënave: - Mbledhja e të dhënave përfshin grumbullimin e të dhënave nga libra të autorve të ndryshëm, si dhe materiale nga interneti. Bibliografia nuk shërben vetëm si tregues i hulumtimit në fjalë, por është shumë e rëndësishme edhe për lexuesin, sepse i jep të dhënat e nevojshme, në mënyrë që studiuesit e tjerë të gjejnë më lehtë burimin.

Faza e tretë: analiza e të dhënave:- Në realizimin me sukses të objektivave të caktuara në këtë studim jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës, ku të dhënat e grumbulluara janë strukturuar sipas kërkesës së studimit.

Gjetjet e këtij hulumtimi janë të vlefshme për secilin studiues i cili në një apo mënyrë tjetër dëshiron t'i shtoj njohuritë mbi historikun e kushtetutës së Kosovës, mbi sfidat dhe barrierat me të cilat është ballafaquar deri në jetësimin e plotë të kushtetutës pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Fjalët kyçe: Kushtetutë, Historiku, Kosova.